

Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

15 Shtator, 2022

Të Dashur Familje dhe Studentë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Ndërsa i afrohem periudhës njëmuajore të vitit shkollor 2022-23, po shkruaj për të ndarë dy përditësime në përputhje me angazhimin tonë për të ofruar përvoja akademike të plota dhe pasuruese për nxënës në **të gjitha** shkollat.

Zgjedhja e Shkollës

Për t’ju kujtuar , Proçesi i Zgjedhjes së Shkollës për vitin shkollor 2023-24 hapet nesër, e Premte, 16 Shtator, në orën 16:00 pm dhe do të mbyllet të Premten, më 4 Nëntor, në orën 23:59 pm. Proçesi i zgjedhjes së shkollës lejon nxënësit që janë aktualisht në P/K deri në klasën e 11-të për të aplikuar për të ndjekur çdo shkollë me hapësirë të disponueshme jashtë lagjes ose zonës së tyre për vitin e **ardhshëm shkollor**.

Sigurohuni që të vizitoni schoolselect.philasd.org për të mësuar më shumë rreth proçesit të Zgjedhjes së Shkollës, duke përfshirë kriteret e pranimit në shkollë dhe për të aksesuar burime si Panairi i Shkollës së Mesme ose “High School Directory” të cilat do të jenë të disponueshme deri në fund të këtij muaj.

Modeli i Shkollave në Shekullin e 21-të

Drejtoria Arsimore është e emocionuar për të nisur një model të ri të shkollave të shekullit të 21-të në tre shkolla të mesme të lagjeve për vitin shkollor 2023-24, me synimin për të zgjeruar modelin në shkollat e tjera të mesme të lagjeve në vitet e ardhshme! Modeli i Shkollave të shekullit të 21-të partnerizon shkollat e mesme të lagjes me biznese dhe organizata jofitimprurëse në të gjithë Filadelfia për të ndihmuar në përgatitjen e studentëve për sukses në industrinë me kërkesë të lartë pas diplomimit:

- **Bartram:** Programimi i Industrisë së Transportit dhe Logjistikës duke përfshirë mekanikën e automobilave, menaxhimin e furnizimit dhe deponimin.
- **Overbrook:** Programimi i Industrisë së Argëtimit duke përfshirë dizajnin dixhital, prodhimin e filmit, televizionit dhe muzikës dhe menaxhimin e argëtimit.
- **West Philadelphia:** Programimi i Industrisë së Zhvillimit Urban, duke përfshirë pasuritë e paluajtshme, teknologjinë e informacionit, sipërmarrjen dhe artet dhe studimet kulturore.

Pas zgjedhjes së një rruge kariere të bazuar në industri, studentët në këto shkolla do të mësojnë një kurrikulë të integruar dhe të përqendruar në karrierë, do të marrin udhëzime në klasë dhe

përvojë në terren, do të fitojnë certifikata të aplikueshme të industrisë dhe më shumë. Ata gjithashtu do të kenë akses shtesë në praktika çdo vit dhe mundësi punësimi pas përfundimit të suksesshëm të programit.

Ne do të ofrojmë përditësime rreth zbatimit të modelit të shkollave të shekullit të 21-të gjatë vitit shkollor. Ndërkohë, mësoni më shumë rreth punës sonë për të përgatitur studentët për kolegji dhe karrierë [këtu](#).

Në javët dhe muajt e ardhshëm, unë do të ndaj me ju mendimet dhe idetë e mia rreth mënyrës sesi *së bashku* mund ta bëjmë Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, drejtorinë arsimore të përmirësohet më shpejtë për arritjen e rezultateve të suksesshme për të gjithë nxënësit. Pres me padurim përpjekjet tona të përbashkëta në vazhdim.

Sinqerisht,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias